

Historiku i Bordin Industrial Këshilldhënës (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike-FIEK)

Më 13 nëntor 2008, me iniciativën e ish-dekanes së Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Prof. Dr. Myzafere Limanit dhe përkrahjen e USAID-it, me vullnetin e mirë të bizneseve të mëdha në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve (TIK) për herë të parë në Universitetin e Prishtinës, u themelua Bordi Industrial (tash Trupa Këshillëdhënëse). Ky Bord nuk kishte ndonjë strukturë të caktuar organizative, mirëpo kontribuoj shumë në ngritjen e cilësisë së programeve studimore duke futur lëndë zgjedhore të reja të cilat ishin me interes për industrinë dhe studentët. Në këtë kuadër u angazhua edhe një numër i caktuar i ekspertëve nga industria . Gjithashtu, TK-ja e FIEK-ut ka propozuar dhe e ka përkrahur idenë që puna praktike të jetë obligative, të realizohet tek bizneset dhe të jetë e barazvlefshme me 6 ECTS. Kjo praktikë është treguar shumë e sukseshme dhe është mirëpritur nga studentët. TK-ja e FIEK-ut ka dhënë kontribut të çmuar në vlerësimin e planeve dhe programeve mësimore, në procesin e akreditimit. Ekspertët ndërkombëtarë e kanë vlerësuar shumë të dobishëm mendimin e TK-së për programet e propozuar për akreditim dhe konsiderohet që kjo ka qenë një nga kriteret kryesore që FIEK ka marr akreditim për të gjitha programet me të cilat ka aplikuar, për kohëzgjatjen maksimale prej 5 vjet.



Figure 1. Takimi për Formalizmin e Bordit Industrial Këshillëdhënës të FIEK

Duke vlerësuar rëndësinë e Bordit Industrial Këshillëdhënës, me iniciativën projektit të Zyres Zvicerane për Bashkëpunim (SDC) "Rritja e punësimit për të rinj-EYE", të implementuar nga Helvetas Swiss Intercooperation dhe Management Development Associates, më 25 tetor 2013 menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës dhe dekanët e njësive akademike, shqyrtuan mundësinë e formalizimit të bordeve industriale. Si rezultat i këtyre diskutimeve, Prof. Asoc. Dr. Enver Hamiti, prezantoi Rregulloren mbi Bordin Industrial Këshillëdhënës (tani Trupa këshillëdhënëse), e cila u miratua nga Këshilli i i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike më datën 14. Janar 2014. Rezultatet pozitive të punës së trupës këshillëdhënëse të FIEK-ut kontribuan që një vit pas, kjo rregullore të përmirësohet dhe adaptohet për nevojat e të gjitha njësive akademike. Gjithashtu, për të mënjeluar keqkuptimet edhe emërtimi "Bordi Industrial Këshillëdhënës" u ndryshua në "Trupa këshillëdhënëse" e njësive akademike. Kjo rregullore me ndryshime u miratua nga senati i UP-së, më datën 29 dhjetor 2014.

Anëtarë të trupës këshillëdhënëse të këtij fakulteti janë kryesisht përfaqësues të shoqatave, instituteve, dhe kompanive private dhe publike të cilat operojnë në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimeve, por edhe të tjera, si: Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK), Autoriteti Rregullativ të Telekomunikacionit, KOSTT, Autoriteti i Aviacionit Civil, Hekurudhat e Kosovës, InterAdria, Comtel, 3CIS, Posta dhe Telekom i Kosovës, KEK dhe Microsoft.

Kryetarë i TK-së së FIEK-ut është Z. Gazmend Kajtazi, drejtor në kompaninë InterAdria.